



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJESJELLES KANALIZIME SH A MALIQ

Nr. 10/1 Prot

Maliq më 10/10/2023

RAPORT PËRFUNDIMTAR LIKUIDIMI

Hyrje.

Shoqëria Ujesjellës Kanalizime Sh.a Maliq në likuidim, është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NIPT J64103106D, me aksionarë Bashkinë Maliq, zoterues i 92.15% të aksioneve të kapitalit, Bashkinë Korçë me 5.69% të aksioneve të kapitalit dhe Bashkinë Devoll me 2.16% të aksioneve të kapitalit.

Në përputhje me parashikimet në VKM nr. 302, datë 11.05.2022, si dhe akteve të tjera të asamblesë dhe administratorëve, shoqëria Ujesjellës Kanalizime Sh.a Maliq ka transferuar veprimtarinë dhe të gjitha aktivet dhe detyrimet, në favor të Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë sha, në datën 31.10.2022. Nga kjo datë, shoqëria nuk ka më të drejta për të zhvilluar veprimtarinë për të cilën ishte themeluar e në këto rrethana, nëpërmjet vendimit Nr. 5, datë 16.3.2023, asambleja e aksionarëve ka vendosur që shoqëria të priset dhe ka hapur procedurat e likuidimit të shoqërisë në gjendjen e aftësisë paguese. Në këtë vendim, asambleja ka emëruar si Likuidues të shoqërisë Z. Petrit Kupe. Ky vendim asambleje është publikuar rregullisht në QKB në datën 13.04.2023.

Likuidimi i shoqërive rregullohet nga nenet 190 deri 203, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar dhe këtu përcaktohen edhe të drejtat dhe detyrimet e likuiduesit.

Gjendja pasurore e shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit.

Në përmbushje të parashikimeve ligjore, është hartuar bilanci i gjendjes së shoqërisë në datën 16.3.2023, i cili përbën bilancin në çastin e hapjes së likuidimit. Në vijim po paraqesim komente mbi bilancin dhe gjendjen e aktiveve dhe detyrimeve në çastin e hapjes së likuidimit.

Shoqëria Ujesjelles Kanalizime Sh.a Maliq ne likuidim, sipas bilancit, ka pasur gjendje aktive afatshkurtra ne vleren **327,505,299** leke, të cilat janë në tërësi të drejta ndaj Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë Sha. Këto janë të drejta që rezultojnë si diferencë midis aktiveve dhe detyrimeve të transferuara në procesin e riorganizimit në përputhje me VKM 302, datë 11.05.2022.

Në çastin e hapjes së likuidimit, Shoqëria Ujesjelles Kanalizime Sh.a Maliq nuk ka pasur detyrime.

Vlera e kapitalit në çastin e hapjes së likuidimit është **327,505,299** leke dhe është e barabartë me të drejtat ndaj Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë Sha. Në vijim paraqitet struktura dhe përbërja e kapitalit në atë datë.

Emërtimi	Vlera Lekë
Kapitali aksionar	453,137,000
Rezerva rivlerësimi	30,804,278
Rezerva ligjore	152
Humbje te pa shperndara	-156,436,131
Totali i kapitalit	327,505,299

Veprimtaritë e shoqërisë nga data 1.1.2023 deri në çastin e hapjes së likuidimit.

Pasqyrat e fundit financiare të shoqërisë janë pasqyrat vjetore të datës 31.12.2022, ndaj në bilancin e gjendjes në çastin e hapjes së likuidimit përfshihet edhe një pasqyrë e fitimeve dhe humbjeve nga data 1.1.2023 deri në çastin e hapjes së likuidimit në datën 16.3.2023.

Për periudhën nga data 1.1.2023 deri në datën e shpalljes në likuidim në datën 16.3.2023 shoqëria ka kryer shpenzime në vlerën 350.100 lekë, të cilat detajohen si vijon.

Paga administratori 300.000 lekë

Sigurime shoqërorë 50.100 lekë

Total 350.100 lekë

Këto shpenzime, në bazë të VKM 302 janë paguar nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë sha dhe kjo shumë është njohur në të ardhura si subvencion i periudhës. Si rrjedhojë, rezultati financiar për periudhën 1.1.2023 deri në çastin e hapjes së likuidimit më 16.3.2023 është zero dhe nuk ndikon në kapitalet e veta apo detyrimet dhe aktivet e shoqërisë.

Te ardhurat	350,100
Shpenzimet	-350,100
Rezultati Financiar	0

Veprimtaritë e likuiduesit pas marrjes së detyrës.

Në vijim janë ndjekur procedurat e parashikuara nga ligji dhe konkretisht si vijon.

- Eshte derguar per publikim njoftimi i pare per kreditorët shkresa nr 7 prot date 03.04.2023, publikuar ne QKB me nr 10823 prot date 16.05.2023
- Eshte derguar per publikim njoftimi i dyte per kreditorët shkresa nr 7/1 prot date 21.06.2023, publikuar ne QKB me nr 13936 prot date 30.06.2023.

Gjate kesaj periudhe nuk janë depozituar kerkesa apo pretendime nga kreditorë te mundshëm ndaj shoqërisë.

Pasi është zbatuar afati prej 30 ditë pas publikimit të njoftimit të dytë, në datën 31.7.2023 është hartuar një bilanc i gjendjes së shoqërisë, i cili konsiderohet si bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së likuidimit. Ky bilanc përfshin edhe një pasqyrë të fitimeve dhe humbjeve për periudhën e likuidimit, që fillon nga çasti i hapjes së likuidimit në datën 16.3.2023 deri në çastin e mbylljes së likuidimit në datën 31.7.2023.

Veprimtaritë e shoqërisë gjatë periudhës së likuidimit.

Gjatë periudhës nga data e hapjes së procesit të likuidimit në datën 16.3.2023 deri në datën 31.7.2023 shoqëria ka kryer shpenzime në vlerën 466.800 lekë të detajuara si vijon.

Paga likuiduesi 400.000 lekë
Sigurime shoqërorë 66.800 lekë
Total 466.800 lekë

Këto shpenzime, në bazë të VKM 302 janë paguar nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë sha dhe kjo shumë është njohur në të ardhura si subvencion i periudhës.

Te ardhurat	466,800
Shpenzimet	-466,800
Rezultati Financiar	0

Si rrjedhojë, rezultati financiar për periudhën e likuidimit është zero dhe nuk ka ndikuar në ndryshimin e aktiveve, detyrimeve apo kapitalit, të cilat mbeten ashtu siç paraqiteshin në çelje të likuidimit.

Gjatë periudhës së likuidimit nuk janë zhvilluar aktivitete apo veprime të tjera.

Gjendjet e aktiveve, detyrimeve dhe kapitalit në mbyllje të likuidimit.

Pra në datën e mbylljes së likuidimit, detyrimet janë zero dhe aktivet dhe kapitali neto paraqiten në të njëjtën vlerë 327,505,299 lekë. Kapitali reflektohet në aktive në formën e të drejtave ndaj Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë sha për kontributin neto të dhënë në formën e transferimit të veprimtarive, aktiveve dhe detyrimeve.

Shpërndarja e aktiveve.

Pas hartimit të bilancit të gjendjes në çastin e hapjes së likuidimit dhe bilancit të gjendjes në çastin e mbylljes së likuidimit, në datën 31.7.2023 është hartuar edhe një raport likuidimi nga likuiduesi i shoqërisë. Këto akte janë miratuar nga asambleja e aksionarëve nëpërmjet vendimit të asamblesë Nr. 6, datë 31.7.2023.

Në vijim, në përputhje me nenin 201 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, është vepruar me shpërndarjen e aktiveve, të cilat u shpërndahen aksionarëve sipas të drejtave që ata kanë në ndarjen e fitimeve.

Rrjedhimisht, të drejtat ndaj Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë sha do të transferohen në favor të aksionarëve në kapital si vijon.

Aksionari	Përqindja e pjesëmarrjes	Vlera në Lekë e të drejtave në SHRUK Korçë SHA
Bashkia Devoll	2.16%	7,074,114
Bashkia Korçë	5.69%	18,635,052
Bashkia Maliq	92.15%	301,796,133
TOTAL	100.00%	327,505,299

Për këtë, na datën 10.10.2023 janë përgatitur shkresa zyrtare, nëpërmjet të cilave janë njoftuar secili aksionar si dhe vetë Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Korçë sha. Këto shkresa do të shërbejnë si titull formal i transferimit të të drejtës përkatëse si dhe si dokument zyrtar për çregjistrimin e këtyre aktiveve nga bilanci i shoqërisë Ujësjellës Kanalizime Sh.a Maliq në likuidim.

Shpërblimet për likuiduesin, sikurse është përshkruar në këtë raport, janë në vlerën prej 400.000 lekë në formën e pagës bruto dhe janë paguar tërësisht.

Në përputhje me nenin 202 të Ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, u hartua ky raport përfundimtar likuidimi, nëpërmjet të cilit, pas miratimit nga asambleja e aksionarëve, do të njoftohet Qendra Kombëtare e Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe do të kërkohet çregjistrimi i shoqërisë.

Likuidues

Petrit Kupe

10 Tetor 2023

